



**BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE
PËR VITIN 2024**

Prishtinë, nëntor 2023

PËRMBAJTJA E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË TERMIKE

HYRJE	3
PERFORMANCA ENERGJETIKE NË SEZONAT E KALUARA	3
Energjia termike e prodhuar, energjia e liferuar dhe humbjet në MWth.....	3
Humbjet e Ujit.....	5
SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE	6
Historiku.....	6
Përshkrimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike	7
Përshkrimi i rrjetit të shpërndarjes	8
Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike	9
PLANI I FURNIZIMIT TË KONSUMATORËVE ME ENERGJI TERMIKE	14
Metodologjia.....	14
Detaje lidhur me parashikimin e kërkesës	15
Humbjet në rrjet	16
Prodhimi i energjisë termike	17
Planifikimi i remonteve, riparimeve dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit.....	19
Emetimi i ndotësve të ajrit nga impiantet e prodhimit të energjisë termike.....	22
PËRMBLEDHJE E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË	23

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike, është përpiluar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (neni 8) dhe “Rregullën dhe metodologjinë për përgatitjen e bilanceve të energjisë elektrike dhe termike”, ku specifikohet se Bilanci vjetor zhvillohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria e Ekonomisë, dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Ky dokument hartohet në këtë format dhe paraqet planifikimin për një periudhë sezonale (vjetore) të kërkesës për energji termike dhe prodhimit të nevojshëm të parashikuar për të plotësuar këtë kërkesë. Gjithashtu janë bërë edhe parashikimet për humbjet në rrjetin e transportit dhe të shpërndarjes së energjisë termike.

Të dhënat e paraqitura në këtë Bilanc, janë të bazuara në të dhënat historike të sezoneve të fundit, në projeksionet zhvillimore aktuale, dhe në dokumentet (strategjitë, studimet) relevante, prandaj të dhënat e paraqitura mund të konsiderohen se kanë saktësi dhe besueshmëri relative.

PERFORMANCA ENERGJETIKE NË SEZONAT E KALUARA

Energjia termike e prodhuar e furnizuar dhe humbjet në rrjet

Energjia termike e prodhuar nga koogjenerimi dhe në ngrohtore në sezonin 2022/'23 ka qenë 308,204 MWht apo 4.5% më i madh se sa në sezonin paraprak 2021/'22 dhe për 6.3% më i madh se sa në sezonin 2020/'21. Liferimi i energjisë termike deri tek konsumatorët në sezonin 2022/'23 ka qenë 270,582 MWth, respektivisht 5.2% më i madh se sa në sezonin paraprak 2021/'22, dhe 6.4% më i madh krahasuar me sezonin 2020/'21. Ndërsa, humbjet e përgjithëshme të energjisë termike në këtë sezonë 2022/'23 kanë qenë 11.9%, përderisa në dy sezonat e kaluara kanë qenë 12.6% dhe 12%.

Në muajin Shkurt 2023 të sezonës ngrohëse 2022/'23, janë konsumuar 5 ton mazut me kaldajën K-2, për marrjen e mostrave për matjen e emitimit të gazrave dhe të pluhurit, e cila ka qenë një prej kushteve të caktuara për aplikim për marrjen e Lejes mjedisore të integruar.


Në vijim, në mënyrë tabelare dhe grafike janë paraqitur të përmbledhura të dhënat e gjenerimit dhe furnizimit me ngrohje, si dhe humbjet përkatëse për tre sezonat e kaluara 2020/21, 2021/22 dhe 2022/23.

Tabela 1. Energjia e prodhuar, energjia e liferuar tek konsumatorët, humbjet në rrjetin e transportit dhe shpërndarjes së energjisë termike

Sezoni	Të prodhuara nga koogjenerimi dhe në ngrohtore	Të liferuara	Humbjet e përgjithshme në rrjet	
	MWhTH	MWhTH	MWhTH	në %
2022/2023	308,204	270,582	36,761	11.9
2021/2022	294 469	256,616	37,101	12.6
2020/2021	288,653	253,210	34,674	12.0

Sqarim: Nga ndryshimi në mes energjisë së prodhuar dhe të liferuar, është zbritur konsumi vetanak

Fig.1 Diagrami i humbjeve të energjisë termike gjatë tre sezonave ngrohëse



Siç mund të vërehet nga të dhënat e lartpërshkruara, humbjet e energjisë termike në sezonin 2022/2023 kanë pësuar rënie të ndjeshme krahasuar me sezonin 2021/22.

Megjithatë në këtë nivel të humbjeve të energjisë (ujit) në rrjetin e shpërndarjes prej 11.9% në sezonin 2022/2023, kanë ndikuar këta faktorë:

- Është zgjeruar rrjeti dhe për të ka pasur testime hidraulike disa herë;
- Pjesa sekondare e objekteve të reja dhe atyre ku janë ndërruar nënstacionet janë mbushur me ujë nga rrjeti primarë;

- Në segmente të caktuara të rrjetit, të cilat ende nuk janë rehabilituar-ndërruar, humbjet e ujit kanë qenë të konsiderueshme, që karakterizohet edhe me intervenime të shpeshta gjatë sezonit të kaluar.

Humbjet e ujit

Humbjet e ujit gjatë sezonit ngrohës 2022/2023 janë gjithsejtë 69,175 m³ apo 10% më të ulëta se sa në sezonin e kaluar 2021/2022. Ndërsa, krahasuar me sezonin 2020/2021, humbjet e ujit në këtë sezonë janë zvogëluar për 15%. Më poshtë, janë paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike humbjet e ujit për tre sezonat ngrohëse 2022/2023, 2021/2022 dhe 2020/2021.

Tab. 2 Humbjet e ujit m³ në tre sezonat ngrohëse 2022/2023, 2021/2022 dhe 2020/2021

Humbjet e ujit/ m ³	Sezona 2022/2023	Sezona 2021/2022	Sezona 2020/2021
tetor	8,678	13,343	13,694
nëntor	10,115	8,339	11,854
dhjetor	11,048	12,542	12,607
janar	10,179	13,721	11,853
shkurt	9,066	10,130	10,001
mars	10,777	9,669	11,425
prill	9,312	8,759	9,824
Total	69,175	76,503	81,258


Siç mund të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelë, humbjet e ujit kanë treguar ulje nga sezona në sezonë. Faktori kryesorë që ka ndikuar në uljen e sasisë së humbjeve të ujit janë investimet në rehabilitimin e rrjetit.

Humbjet e ujit gjatë sezonit ngrohës 2022/'23 kanë shënuar rënie rreth 10%, ndërsa krahasuar me sezonin 2020/'21, humbjet e ujit në këtë sezonë janë më të vogla për 12,083 m³ apo rreth 15%. Pjesa më e madhe e këtyre humbjeve, paraqet mbushjet e shpeshta të rrjetit sekondar në objektet e reja dhe në objektet e vjetra, aty ku janë instaluar nënstacione të reja.

Megjithatë, SCADA e nënstacioneve, për arsye të ndryshme, ende nuk është funksionalizuar tërësisht, nuk kemi evidencë të saktë për sasinë e ujit të futur në rrjetin sekondar.

Në figurën 2 është dhënë Paraqitja grafike e humbjeve të ujit për tre sezonat ngrohëse, 2020/'21 , 2021/'22 dhe 2022/'23.

Fig. 2 Paraqitja grafike e humbjeve të ujit për tre sezonat ngrohëse



Sistemi i Energjisë Termike

Historiku

NP "Termokos" Sh.A. është furnizuesi i vetëm i ngrohjes qendrore në Prishtinë. Krahas ngrohjes qendrore, NP "Termokos" Sh.A. gjithashtu ofron edhe shërbime të mirëmbajtjes të sistemit të ngrohjes qendrore për konsumatorët e saj. Kërkesa për ngrohje qendrore të ofruar nga NP "Termokos" Sh.A. është jashtëzakonisht e lartë, kjo për arsye se NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje kualitative 24 orë gjatë gjithë sezonit ngrohës dhe me çmim më të lirë se sa alternativat tjera të ngrohjes.

Aktualisht, NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje qendrore për 20,567 konsumator (prej të cilëve 18,717 janë konsumatorë banesorë dhe 1,850 konsumatorë afarist e institucional). Përderisa, numri i konsumatorëve potencial që parashihet të kyçen në sistemin e ngrohjes qendrore të NP "Termokos" Sh.A në vitin 2024 është përafërsisht 3,575 konsumatorë, prej të cilëve 3,239 konsumatorë të amvisërisë dhe 336 konsumatorë afarist.

NP "Termokos" Sh.A. mbulon kërkesën për ngrohje të konsumatorëve ekzistues duke mos shfrytëzuar tërësisht kapacitetin ekzistues. Kjo dërgon drejt konkluzionit

që NP “Termokos” Sh.A., mund të ofrojë ngrohje qendrore për konsumatorë të rinjë të cilët mund të kyçen në rrjetin e NP “Termokos” Sh.A.

Përshkrimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike

Njësi bazë gjeneruese e energjisë termike është TC Kosova B, përmes sistemit të koogjenerimit. Kapaciteti i instaluar është 140 MWTH, ndërsa kapaciteti operativ vlerësohet të jetë 137.48 MWTH. Për prodhimin e energjisë termike shfrytëzohet avulli i cili ekstrahohet nga shkalla e PM e të dy turbinave në këtë termocentral. Këmbimi i energjisë avull/ujë, bëhet në stacionin për ekstraktim të energjisë HES përmes dy këmbyesve me kapacitet nga 70MWTH. Ky stacion është në afërsi të TC Kosova B, dhe në tërësi menaxhohet nga Termokosi.

Tabela 3. Kapacitetet e prodhimit të energjisë termike nga koogjenerimi

Njësia gjeneruese	Kapaciteti I instaluar	Kapaciteti total	Viti I prodh./instal.	Vendi
Sistemi I koogjene.-TC Kosova B	2x70 MW	140W	2014	TC Kosova B

Termokosi disponon edhe me kapacitete të veta të prodhimit të energjisë termike me kaldajat me lëndën djegëse mazut, të cilat janë përdorur para funksionalizimit të sistemit të koogjenerimit. Këto kapacitet prodhuese janë kapacitet rezervë për t’u përdorur në raste specifike (në rast të ndërprerjes së furnizimit nga KEK – TC Kosova B dhe mbulimi i kërkesës për energji në pikun e ngarkesës).

Megjenëse, Licenca e Prodhimit të energjisë termike të NQ “Termokos”, ka skaduar me 14 tetor 2021, dhe në kuadër të plotësimit të kushteve për vazhdimin e kësaj licence, sipas nenit 11- Mjedisi, nga ZRRE është kërkuar pajisja me “Leje Mjedisore”.

Lidhur me këtë, nga MMPHI është lëshuar Vendimi për Pëlqim Mjedisor për NP”Termokos”SHA me datë 27 .06.2022.

Ndërsa me datë 09.08.2022 kemi Aplikuar për Leje Mjedisore të Integruar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI), ku janë dërguar Aplikacioni i plotësuar dhe dokumentet mbështetëse .

Pas kësaj, mbështetur në kërkesën e MMPHI të datës 09.09.'22, dhe kërkesave plotësuese nga zyrtarët e MMPHI nga takimet konsultative të përbashkëta, me datë 08.12.2022 dhe 11.05.2023, kemi dërguar dokumentacionet plotësuese dhe riplotësimin e pikave të Aplikacionit, në të cilin, ndër të tjera është dërguar edhe "Raporti i matjeve të emisionit të gazrave djegëse dhe të pluhurit" nga Enti i hulumtimeve "INKOS" Sh.A, sipas matjeve të bëra me datë 02.02.2023 në ngrohtoren qendrore Termokos.

Duke vlerësuar se janë plotësuar kriteret dhe dokumentacionet e kërkuara nga MMPHI, jemi në pritje të vendimit të MMPHI për lëshimin e Lejes mjedisore, ashtu që NQ Termokos të mund filloj procedurat në ZRRE për vazhdim të licencën e operimit, dhe rrjedhimisht të mundet të operoj kaldajat me mazut, si kapacitet rezervë vetëm në rast ndërprerjes së furnizimit nga stabilementet e kogjenerimit në TC Kosova B. Në tabelën 4. janë paraqitur kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit të energjisë termike me të cilat disponon NP"Termokos "sh.a .

Tabela 4. Kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit të energjisë termike

Njësia gjeneruese	Kapaciteti i instaluar	η (%)	Kapaciteti operativ	Lënda djegëse	Kons.l.d. Kg/MWh	Viti i prodhimit /inst.	Vendi i instalimit
Sistemi I kogjenerimit TC Kosova B	2x70= 140 MW _{TH}	98	137.48 MW _{TH}	Linjit	-	2014	TC Kosova B
Kaldaja me ujë të nxehtë	2x58= 116 MW _{TH}	85	98.6 MW _{TH}	Mazut	105	1978	Termokos
	2x7= 14 MW _{TH}	90	12.6 MW _{TH}	Dizel	96	1983	Ngrohtorja e QKUK
	4 MW _{TH}	90	3.6 MW _{TH}	Mazut	96	2003	Termokos
Total kapaciteti i ngrohtores	134 MW _{TH}	85.6	114.8 MW _{TH}	-	-	-	-
Total kapaciteti gjenerues	274 MW _{TH}	92	252.28 MW _{TH}	-	-	-	-

Përshkrimi i rrjetit të shpërndarjes

Rrjeti primar i shpërndarjes me gjatësi të tubacionit prej 113.6 km dhe kapacitet të ujit prej 4000 m³, është i instaluar kryesisht në vitet e 70-ta, në pjesën e urbanizuar të Prishtinës. Pas investimeve intenzive në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit,

posaçërisht në vitin e fundit, është arritur që rreth 95% e rrjetit të shpërndarjes të jetë me gypa të rinjë të paraizoluar kurse pjesa tjetër me gypa të amortizuar.


Përshkrimi i karakteristikave kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 5. Karakteristikat kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes

Rrjeti i shpërndarjes dhe nënstationet - NP "Termokos" Sh.a.		
Numri i nënstationeve	Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i matësve në termonënstacione
900	113.6	Nga 900 nënstatione, në 850 nënstatione janë të vendosur matësit dhe janë funksional, kurse në 50 nënstatione (kryesisht nënstatione të vogla për nga kapaciteti) nuk ka matës.
880 aktive		
20 pasive		

Në figurën më poshtë është paraqitur skema e rrjetit aktual të shpërndarjes së energjisë termike.

Figura 3. Shtrirja e rrjetit të ngrohjes qendrore



Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike

Termokosi, planet afatgjata për prodhimin të energjisë termike i bazon në sistemin e koogjenerimit, si burim i sigurt, ekonomikisht i favorshëm dhe i përshtatshëm në kuptim të mbrojtjes së ambientit. Kapaciteti aktual prej 140MWTH (2x70 MWTH) dhe aftësia bartëse e termopërquesit (Rrjetit të transportit të energjisë termike) TC Kosova B – Termokos prej 160 MWTH, janë faktorë limitues për ekstraktim më të madh energjisë. Bazuar në donacionet dhe investimet me mjete vetanake të NP "Termokos" sh.a viteve të fundit janë bërë investime të mëdha në zgjerimin e rrjetit dhe rehabilitimin e sistemit të ngrohjes qendrore. Gjithashtu edhe viteve në vijim pritet të ketë investime të mëdha në rrjetin e ngrohjes për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit, që rezulton në rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore.

Detajet janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 6. Skenari 1. Projektioni i Ulët

Viti	Investimet /mil €	Zgjerimi i sipërfaqes /m ²	Sipërfaqja aktuale e kyçur /m ²	Sipërfaqja totale e kyçur /m ²
2024	4.5-5.5	185,000.00	1,786,834.76	1,971,834.76
2025	5.5-6.5	210,000.00	1,971,834.76	2,181,834.76

Tabela 7. Skenari 2. Projektioni i Mesëm

Viti	Investimet /mil €	Zgjerimi i sipërfaqes /m ²	Sipërfaqja aktuale e kyçur /m ²	Sipërfaqja totale e kyçur /m ²
2024	4.5-6.5	251,932.48	1,786,834.76	2,038,767.24
2025	5.5-7	270,000.00	2,038,767.24	2,308,767.24

Tabela 8. Skenari 3. Projektioni i Lartë

Viti	Investimet /mil €	Zgjerimi i sipërfaqes /m ²	Sipërfaqja aktuale e kyçur /m ²	Sipërfaqja totale e kyçur /m ²
2024	5.0-7	285,000.00	1,786,834.76	2,071,834.76
2025	5.5-7.5	300,000.00	2,071,834.76	2,371,834.76

Zgjerimi i sipërfaqes i planifikuar për vitin 2024, planifikohet të realizohet bazuar në subvencionet /donacionet për zgjerim të rrjetit dhe me vetfinansim.

Projektet nga donacionet dhe me vetëfinancim të planifikuara për vitin 2024:

1.Projekti i KfW, për “Rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore në qytetin e Prishtinës”

Projekti në total ka mbërri vlerën rreth 19 mil. euro, Si donacion nga Qeveria Gjermane përmes KfW dhe Qeveria e Luksemburgut janë paguar 10.62mil euro, kurse pjesa tjetër e projektit në vlerë rreth 8.5 milion euro mbulohet nga fondet vetanake të NP “Termokos” SH.A si bashkëfinancues i këtij projekti. Ky bashkëfinancim është dedikuar për mbulimin e kostos për zgjerimin e rrjetit në lagjet Mati 1 dhe Arbëria, për arsye se në krahasim me kohën kur është bërë projekti fillestarë, ka pasur ndërtime të objektetve të reja.

Ky projekt është i ndarë në dy pako tenderuse, të cilat janë vazhdimësi e projektit të kogjenerimit. Vlera e totale për dy pakot e projektit (T-1 dhe T-2) dhe për shërbimet e konsulencës, që planifikohet të realizohet deri në përfundim të këtij projekti është rreth 6.8 milion euro. Kjo shumë duhet të paguhet nga NP “Termokos” SH. A. si bashkëfinancim, për shkak se fondet nga donacionet për këtë projekt kanë mbaruar.

Pakoja T-1 – Kjo kontratë përmbanë instalimin e nënstacioneve të reja , në pjesët e zgjerimit të rrjetit, rahabilitimin e nënstacioneve ekzistuese, duke përfshirë edhe programin SCADA (kontrollë nga distanca) dhe ndërtimin e rezervuarëve të nxehtësisë. Kontrata për këtë pako me konzorciumin Brunata & Ergotem, ka hyrë në fuqi me 12.01.2022. Punët e planifikuara me këtë pjesë të projektit janë duke u zhvilluar.

Sipas këtij projekti, do të bëhet instalimi i 320* nënstacioneve të reja në pjesën që i përket zgjerimit të rrjetit, dhe rehabilitimi/ modernizimi i 270 nënstacioneve ekzistuese.

Sqarim - (Fillimisht sipas projektit ka qenë e paraparë të instalohen 333 nënstacione të reja, në parimin një objekt një nënstacion, por gjatë zhvillimit të projektit për shkaqe të ndryshme, p.sh mungesë e hapësirës për nënstacion, etj. janë lidhur dy ose me tepër objekte në një nënstacion, duke rritur kapacitetin e nënstacionit).*

Pjesë e projektit është edhe ndërtimi i dy rezervuarëve të nxehtësisë me kapacitet 2x400m³, integrimi i këtij sistemi në SCADA si dhe rehabilitimi i sistemit për mbajtje të shtypjes në rrjetin shpërndarës.

a) Zgjerimi i rrjetit me nënstacione të reja plotësisht të automatizuara me kapacitete të ndryshme nga 10kW deri në 1.2MW janë planifikuar të instalohen në lagjet e poshtëshënuara dhe deri në muajin tetor 2023 janë kryer këto punime:

1. Mati jug- 134 nënstacione të reja, nga të cilat janë instaluar 119 nënstacione dhe është duke vazhduar instalimi i nënstacioneve të reja.

2. Qendër lindje, përkatësisht lagjeja afër Parkut të qytetit – 64 nënstacione të reja, nga të cilat janë instaluar 48 nënstacione dhe është duke vazhduar instalimi i nënstacioneve të reja.

3. Arbëria -36 nënstacione të reja , nga të cilat janë instaluar 28 nënstacione dhe është duke vazhduar instalimi i nënstacioneve të reja.

Prandaj deri në muajin tetor 2023 në kuadër të zgjerimit të rrjetit janë instaluar 195 nënstacione të reja.

Me densifikim të rrjetit, sipas projektit do të kyçen 86 nënstacione të reja në rrjetin ekzistues të ngrohjes, në këto lagje të qytetit:

- Ulpiana - 23 nënstacione,
- Dardania - 13 nënstacione,
- Qyteza Pejton - 9 nënstacione,
- Qendër - 40 nënstacione,
- Bregu i Diellit - 1 nënstacione.

Deri në muajin tetor 2023, në kuadër të dendsifikimit të rrjetit janë instaluar 68 nënstacione të reja dhe është duke vazhduar instalimi i nënstacioneve të tjera.

Automatizimi/modernizimi i nënstacioneve termike sipas këtij projekti do të bëhet në 36 nënstacione, nga të cilat 28 janë instaluar dhe është duke vazhduar instalimi i nënstacioneve të tjera.

Pjesë e këtij projekti është edhe ndërtimi i dy Rezervuarëve për ujë të ngrohtë (Buffer tank) me kapacitet $2 \times 400 \text{m}^3$, që do të vendosen në oborrin e Termokosit dhe do të shërbejnë për të ruajtjen e energjisë termike, e cila do të shfrytëzohet për mbulimin e kërkesave për energji.

Në pjesën e projektit që i referohet Rezervuarëve të nxehtësisë, punët përgaditore në teren kanë filluar në fillim të marsit 2023 dhe deri tani janë kryer këto punime:

- Ka përfunduar instalimi i plakave sektoriale dhe kapelave të rezervuarëve;
- Janë në përfundim punimet në instalimin e gypave nga rezervuarët deri te kolektorët brenda kaldatorës,

- Janë duke vazhduar punimet për instalimin e pompës së transimisionit (koogjenerimit);
- Janë në përfundim punimet për instalimin e sistemit për mbajtje të shtypjes;
- Janë duke vazhduar punimet për instalimin e sistemit për degasifikim;
- Ka përfunduar instalimi i pompës së pestë në sistemin e qarkullimit, ka mbetur vetëm balancimi ,
- Janë duke vazhduar punimet elektroinstaluese,
- Është instaluar sistemi për trajtimin e ujit mirëpo ende nuk është vënë në punë.
- Filtri elektromagnetik është instaluar por ende nuk është vënë në punë.

b) Rehabilitimi/modernizimi i 270 nënstacioneve ekzistuese, në lagjet ekzistuese Ulpiana, Dardania, Bregu i diellit dhe Qendër, nga të cilat deri më tani janë instaluar 228 nënstacione dhe është duke vazhduar instalimi i nënstacioneve të reja.

Pakoja T-2 -Në këtë kontratë përfshihet furnizimi dhe instalimi i rrjetit gypor në pjesët e qytetit ku planifikohet zgjerim dhe densifikim i rrjetit të ngrohjes qendrore, si dhe rehabilitim i segmenteve të caktuara të rrjetit ekzistues të tubacioneve.

Kontrata për këtë pako, është nënshkruar me kompaninë ALLZone, dhe ka hyrë në fuqi me 15.01.2021.

Zhvillimi i punimeve për zgjerimin e rrjetit, ka filluar në muajin maj të vitit 2021 në lagjen Mati 1 nga Kontraktor i ALL ZONE LLC. Për realizimin e Projektit për "Rehabilitim / zëvendësim dhe zgjerim të tubacioneve në rrjetin e qytetit", kompania punëkryese do të kryej punimet për :

- Zgjerimi i rrjetit -23. 5km gyp të paraizoluar,
- Densifikimi i rrjetit -6km gyp të paraizoluar,
- Rehabilitimi i rrjetit- 12 4km gyp të paraizoluar.

Për realizimin e projektit në kuadër të zgjerimit dhe densifikimit të rrjetit , deri në muajin tetor 2023 janë instaluar rreth 30 km gyp. Ndërsa sa i përket rehabilitimit të rrjetit, deri në muajin tetor 2023 është realizuar rehabilitimi/ndërrimi i gypave i rreth 13 km gyp me dimensione nga DN32 deri DN250. Ndërsa, pjesa tjetër e projektit do të realizohet në vitin 2024.

2. Projekti për instalimin e matësve të nxehtësisë-projekti i MCC

Kontratën për këtë projekt, i cili financohet nga fondacioni MCC / Qeveria e SHBA përmes MFK, e ka fituar konzorciumi Enerco-InterAdria, dhe ka filluar së zbatuari me 27.07.2022, Pas Nëntorit të vitit 2022, është bërë një ndryshim dhe riorganizim në projekt. Bazuar në Marrëveshjen Trepalëshe në mes të MCC, Komunës së Prishtinës dhe Termokosit, projekti ka kaluar në përgjegjësi të Termokosit. Fondet e mbetura të MCC, do të menaxhohen nga PIU e këtij projekti, e cila deri në fund të projektit është pjesë e Termokosit. Vlera e këtij projekti aktualisht është rreth 11.7 milion euro.

Në kuadër të këtij projekti do të instalohen matësit e energjisë termike dhe valvulave termostatike në:

- Rreth 300 ndërtesa të banimit kolektiv të kyçura në rrjetin e ngrohjes
- 17,500 konsumatorë shtëpiak dhe komercial.
- 64,000 alokatorëve të nxehtësisë ,
- 5,100 matës individual të energjisë termike dhe
- 85,500 valvula termostatike në radiatorët e konsumatorëve, do të instalohen pompa dhe valvola balancuese në nënstacione.

Gjatë vitit 2024 do të realizohet pjesa e mbetur e projektit. Gjithashtu do të instalohet softveri për lexim, matje dhe faturim dhe sistem të kontabilitetit. Realizimi i këtij projekti përkthet me sasinë e pajisjeve të instaluar deri në muajin tetor 2023, është paraqitur në tabelën 9.

Tabela 9. Sasia e instalimeve hidraulike e realizuar për projektin e MCC deri në muajin tetor 2023

RAJONI	Nr. i Apartmaneve të përfunduara	Valvulat termostatike	Alokatorët	Njehsorët e nxehtësisë	Pompat qarkulluse
ULPIANA	2 322	8 743	7 034	0	26
K. E DIELLIT	4 162	20 261	11 026	324	12
DARDANIA	3 194	13 844	13 714	0	0
QENDRA	2 330	11 603	9 399	422	104
KALABRIA	1 418	6 794	2 291	680	0
MATI I	1 277	5 917	0	195	0
Total:	14 703	671 62	43 464	1 621	142

PLANI I FURNIZIMIT TË KONSUMATORËVE ME ENERGJI TERMIKE

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për parashikimin e kërkesës për ngrohje është bazuar në të dhënat historike të konsumit të ngrohjes, karakteristikat e sistemit të ngrohjes qendrore në kuptim të mundësisë për zgjerimin e rrjetit e rrjedhimisht rritje të bazës së konsumatorëve, si dhe të kapaciteteve prodhuese të energjisë termike. Gjithashtu në parashikimin e kërkesës janë marrë për bazë projeksionet zhvillimore të NP "Termokos" Sh.a, e po ashtu edhe planifikimet e rritjes ekonomike të gjithmbarshme në shkallë vendi.

Projeksionet zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NP"Termokos"Sh.A kryesisht përfshijnë planifikimet për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes e rrjedhimisht rritjen e bazës së konsumatorëve / sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes.

Ndikimi i rritjes së gjithmbarshme ekonomike gjithashtu vlerësohet përmes indikatorëve të zhvillimit ekonomik .

Detaje lidhur me parashikimin e kërkesës për energji termike

Parashikimi i kërkesës për energji termike mund të bazohet në kërkesën/konsumin në rritje në tri sezonet e fundit. Në tabelën 10. është paraqitur konsumi i energjisë në tri sezonat e fundit.

Tabela 10. Realizimi i konsumit të energjisë në tri sezonat e fundit ngrohëse 2022/2023, 2021/2022 dhe 2020/2021

Sezona	Energjia e Prodhuar nga koogjenerimi	Humbjet ne rrjetin e transportit të energjisë		Energjia e prodhuar në Ngrohtoren Termokos	Konsumi vetanak	Energjia e liferuar	Humbjet në rrjetin e shpërndarjes	
		MWht	%				MWht	%
2022/2023	308,156	6,163	2	48.03	855.7	270,582	30,603	10.2
2021/2022	294,373	5,887	2	96.05	752	256,616	31,214	10.8
2020/2021	288,653	5,773	2	0	770	253,210	28,900	10.2

Në sezonet e mëhershme (5 deri në 10 vjetët e fundit) gjer me funksionalizimin e sistemit të koogjenerimit në vitin 2014, furnizimi me ngrohje nga NP"Termokos" Sh.A nuk ka qenë në nivelin e duhur, prandaj edhe kërkesa për kyçje në sistemin e ngrohjes qendrore ka qenë e papërfillshme. Në Masterplan, janë paraparë kahet e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes, përkatësisht përfshirja e

konsumatorëve të rinjë. Numri i konsumatorëve të rinjë, përveç nga fizibiliteti i zgjerimit të rrjetit në pjesë të caktuara të qyteti, determinohet edhe me kapacitetin energjetik në dispozicion nga sistemi i koogjenerimit, i cili aktualisht është 140Mwth. Numri i konsumatorëve të rinjë dhe energjia e angazhuar për ta, është paraqitur në strategjinë e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit shpërndarës të Termokosit (tre skenarë të zhvillimit). Për hartimin e këtij Bilanci është marrë projeksioni (skenari) i mesëm. Siç vërehet nga tabela 7, për vitin 2024 është parashikuar një rritje e sipërfaqes ngrohëse të kyçur prej rreth 251,932.48m².

Ky planifikim për rritje të sipërfaqes ngrohëse është bazuar në subvencionet/donacionet dhe vetfinansim nga Termokosi, për zhvillimin dhe rehabilitimin e sistemit të ngrohjes.

Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës respektivisht furnizimit të konsumatorëve me energji termike i ndarë sipas muajve për vitin 2024.

Tabela 11. Parashikimi i kërkesës/furnizimit për energji termike 2024

KËRKESA E KONSUMATORËVE PËR ENERGJI TERMIKE – VITI 2024									
	Konsumatorët Shtëpiak			Konsumatorët Komercial e Institucional			Total Konsumatorët		
	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e energjisë termike (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e energjisë termike (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)
Janar	1,200,000	108	36,613	640,000	64	28,083	1,840,000	147	64,696
Shkurt	1,230,000	111	30,199	640,000	64	22,163	1,870,000	150	52,362
Mars	1,250,000	113	28,197	645,000	65	20,314	1,895,000	152	48,511
Prill	1,250,000	113	12,155	645,000	65	5,507	1,895,000	152	17,662
Tetor	1,300,000	117	13,378	660,000	66	6,637	1,960,000	156	20,015
Nëntor	1,377,574	124	30,211	660,000	66	22,174	2,037,574	161	52,385
Dhjetor	1,377,574	124	36,622	661,193	66	28,091	2,038,767	161	64,713
Total / Mes.	1,283,593	116	187,375	650,170	65	132,969	1,933,763	154	320,344

Në tabelën më poshtë paraqitet kërkesa e planifikuar për energji termike edhe humbjet në rrjet.

Tabela 12. Parashikimi i kërkesës për energji termikedhe humbjet në rrjet për vitin 2024

KËRKESA PËR ENERGJI TERMIKE (KËRKESA E KONSUMATORËVE PLUS HUMBJET NË RRJET) – VITI 2024								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Kërkesa e konsumatorëve për energji termike (MWh)	64,697	52,362	48,511	17,661	20,014	52,385	64,713	320,344
Total humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	5,626	4,553	4,218	1,536	1,740	4,555	5,627	27,856
Total kërkesa e kons. plus humbjet (MWh)	70,322	56,916	52,729	19,197	21,755	56,941	70,341	348,200

Humbjet në rrjet

Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike (TC Kosova B – NQ Termokos) dhe në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.

Humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike TC Kosova B - N.P Termokos Sh.A, parashihet të jenë 2% apo 6 476 MWh_{TH}.

Në vitin 2024, parashihet që nivel i humbjeve të energjisë termike në rrjetin e shpërndarjes të bie nga 10.2% (që ishte në sezonin e fundit 2022/'23) në 8.0%.

Në tabelën 13, janë paraqitur detajet për humbjet në rrjetin e transportit (koogjenerimit,TC Kosova B – NP Termokos) dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2024.

Tabela 13 .Humbjet në rrjetin e transportit dhe të shpërndarjes së energjisë termike për vitin 2024

HUMBJET NË RRJET - VITI 2024								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/ Mesatare
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	1,438	1,164	1,079	394	445	1,164	1,438	7,124
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportimit (%)	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	5,626	4,553	4,218	1,536	1,740	4,555	5,627	27,856
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes (%)	8.0	8.0	8.0	8.0	8.0	8.0	8.0	8
Total humbjet sasiore në rrjet (MWh)	7,064	5,718	5,297	1,930	2,186	5,720	7,066	34,980
Total humbjet në rrjet në përqindje (%)	10.0	10.0	10.0	10.0	10.0	10.0	10.0	10

Sqarim: Historiku i humbjeve të përgjithshme të energjisë termike për tri vitet e fundit është paraqitur në Tabelën 1 , ndërsa në Tabelën 10 është paraqitur historiku i humbjeve të energjisë termike ndaras për rrjetin e transportit të energjisë termike dhe ndaras për rrjetin e shpërndarjes.

Plani i Prodhimit të energjisë termike

Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin). Gjithashtu planifikimet për prodhimin e energjisë termike reflektojnë edhe humbjet në rrjet, si dhe eficiencën e energjisë.

Siç është thënë më lartë NP“Termokos”Sh.A prodhimin e energjisë termike e bazon në stabilimentet e koogjenerimit në TC Kosova B me kapacitet nominal prej 140MW_{TH}. Mirëpo, NP“Termokos”Sh.A disponon me kapacitet e veta rezervë të prodhimit me kapacitet nominal prej 134 MW_{TH}, që planifikon t'i shfrytëzoj për periodha të shkurta kohore, vetëm në rast të ndërprerjeve të pa-planifikuara të stabilimenteve të koogjenerimit në TC Kosova B.

Për vitin 2024 nuk është planifikuar prodhim i energjisë termike nga mazuti për arsye se, stacioni i mazutit (i vjetëri) është larguar përkohësisht për shkak të liritimit të hapësirës për ndërtimin e objektit të ri administrativ dhe do të rivendoset në një vend tjetër.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur parashikimet vjetore (për vitin 2024) të prodhimit bruto të energjisë termike nga kogjenerimi dhe nga kapacitetet e prodhuese të ngrohtores.

Tabela 14. Prodhimi bruto vjetor i energjisë termike 2024

Prodhimi bruto i energjisë termike	
Prodhimi i energjisë termike nga kogjenerimi (MWh _{TER})	356 189
Prodhimi i energjisë termike në Ngrohtore (MWh _{TER})	0
Total bruto prodhimi (MWh_{TER})	356 189

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat për prodhimin bruto dhe neto të energjisë termike nga kogjenerimi sipas muajve për vitin 2024.

Tabela 15. Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike sipas muajve për vitin 2024

PRODHIMI I ENERGJISË TERMIKE - VITI 2024								
Përshkrimi/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/ Mesatare
Energjia nga lënda djegëse (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore (%)	85%	85%	85%	85%	85%	85%	85%	85%
Bruto prodhimi në stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
Bruto prodhimi në stabilimentet e koogjenerimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	71,924	58,220	53,943	19,693	22,265	58,220	71,924	356,189
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)	71,924	58,220	53,943	19,693	22,265	58,220	71,924	356,189
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	1,438	1,164	1,079	394	445	1,164	1,438	7,124
Konsumi vetanak (MWh)	163	140	135	102	65	115	145	865
Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)	70,322	56,916	52,729	19,197	21,755	56,941	70,341	348,200

Planifikimi i remonteve, riparimeve dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit

Departamenti i Prodhimit / Koogjenerimit

Planifikimet për vitin 2024

1. Ngrohtorja Qendrore (r)
 - 1.1 Revizioni i flakërusve të kaldajes K-2;
 - 1.2 Revizioni i pompave riqarkulluese të kaldajës K-2;
 - 1.3 Remonti i pompave qarkulluese variabile, pompat: 62P1, 62P2, 62P3_dhe 62P4, ndërrimi i kushinetave, puthitësave, boshtit dhe qarkut të pompave, sipas nevojës;
 - 1.4 Freskimi i elektromotorrëve të pompave qarkulluese variabile, sipas nevojës;
 - 1.5 Pastrimi kimik dhe konzervimi i kaldajave në: Ngrohtoren Qëndrore (K-2 dhe K-4)

- 1.6 Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësis në termonenstacionin Kryesor Bregu i Diellit
- 1.7 Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësisë nga njësit e terrenit (distribuimit) sipas kërkesës;
- 1.8 Ndririmi i valvolave DN500 në degen kryesore të Bregut të Diellit/Ulpianë;
- 1.9 Kontrollimi dhe testimi i pajisjeve elektrike dhe automatike.

2. Stacioni për Ekstraktimin e Nxehtësisë-HES

- 2.1 Remonti i pompës së kondenzatit 02RP11D001;
- 2.2 Freskim i motorave të pompave të kondenzatit, sipas nevojës;
- 2.3 Kontrollim i anës ujore të kondenzatorëve të nxehtësisë: KDN-1 dhe KDN-2, dhe sipas nevojës pastrimi kimik nga ana ujore;
- 2.4 Bazhdarimi i matësve të energjisë, bazuar në marrëveshjen për furnizim me ngrohje KEK- Termokos (i obligueshëm sipas marrëveshjes për energji mes KEK-ut dhe Termokosit);
- 2.5 Revizion i valvulave;
- 2.6 Ndërimi i baterive për UPS-in që furnizon komplet panelin e PLC-së.
- 2.7 Kontrollimi dhe testimi i pajisjeve elektrike dhe automatike.

3. Stacioni për pranim të nxehtësisë – HRS(r)

- 3.1 Remont i pompës së koogjenerimit 121_2P001, sipas nevojës;
- 3.2 Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësisë, fuqia termike 3x50MW;
- 3.3 Ndërimi i diktunave dhe pllakëzave të këmbyesve: KN-1, KN-2 dhe KN-3, sipas nevojës;
- 3.4 Revizion i pompave për mbajtje të presionit në rrjetin e koogjenerimit dhe revizioni i paisjes për degasifikim;
- 3.5 Kontrollimi dhe testimi i pajisjeve elektrike dhe automatike.
- 3.6 Revizion i valvulave.

4. Termonenstacioni kryesor i Bregut të Diellit (r)

- 4.1 Riparimi i filtrave DN350mm, në hyrje të termonenstacionit kryesor të Bregut të Diellit dhe riparimi i filtrit DN400mm në pjesën sekondare të B.D;

- 4.2 Remonti i pompave qarkulluese Etanorm, pompës, ndërrimi i kushinetave, sipas nevojës;
- 4.3 Freskimi i elektromotorrëve të pompave qarkulluese 72P1, 72P2 dhe 72P3 ;
- 4.4 Ndërrimi i diktunave dhe fletëzave në këmbyesit të nxehtësisë;
- 4.5 Sipas kërkesës së distribuimit, gjatë sezonit bëhet pastrimi kimik i këmbyesve në të gjitha rajonet e distribuimit, dhe
- 4.6 Kontrollimi dhe testimi i paisjeve elektrike dhe automatike.
- 4.7 Pastrimi kimik i këmbyesve të nxehtësisë në termonënstacionin Kryesor Bregu i Diellit.
- 4.8 Automatizimi i procesit të mbushjes së enëve ekspanduese me ujë dhe Upgrade i SCADA-së në një sistem WinCC Flexible ose WinCC Explorer.

5 Ngrohtorja e Spitalit

- 5.1 Revizioni i flakërusve të kaldajave: K1 dhe K2.
- 5.2 Ndërrimi i pompës qarkulluese në pjesën e QKUK-së,
- 5.3 Pastrimi kimik dhe konzervimi i kaldajave.

6 Rrjeti i koogjenerimit

- 6.1. Identifikimi i depertimit të ujrave nëntokësorë në izolimin e gypave në pjesën "Laguna 1 dhe 2", ndërrimi ose riparimi i izolimit,
- 6.2. Identifikimi i problemit dhe zgjidhja e sistemit të detektimit të rrjedhjeve në rrjet të koogjenerimit,
- 6.3. Revizioni i valvave DN600 në pusetat e koogjenerimit,
- 6.4. Mirëmbajtja e pusetave.

Sqarim: Për termonënstacion të mazutit (të vjetrin) nuk kemi paraparë ndonjë plan të mirëmbajtjes për vitin 2024 sepse është larguar stacioni I mazutit i vjetër për shkak të ndërtimit të objektit të ri administrativ në NQ.

Departamenti i Distribuimit

Zgjerimi i rrjetit të ngrohjes qendrore

Në kuadër të projektit të KfW për zgjerim dhe dendsifikimit të rrjetit me donacionet për këtë projekt dhe me investime vetanake, deri tani janë instaluar rreth 30km gyp. Me instalimin e pjesës së mbetur të këtij projekti rreth 1.5km gyp, gjatësia e përgjithshme e rrjetit në vitin 2024 planifikohet të jetë rreth 113.6km trasë.

Gjithashtu bazuar në zgjerimin e rrjetit me nënstacione të reja (në kuadër të këtij projekti), deri tani janë instaluar 263 nënstacione të reja në kuadër të zgjerimit dhe dendsifikimit të rrjetit të ngrohjes me nënstacione të reja. Kanë mbetë të instalohen edhe 57 nënstacione të reja të kapaciteteve të ndryshme nga 10kW deri në 1.2MW. Kështu që, deri në fund të vitit 2024 planifikohet që sistemi i ngrohjes qendrore të ketë rreth 900 nënstacione, përfshirë këtu edhe 20 nënstacione pasive.

Rehabilitimi i rrjetit

Me projektin e KfW për rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike deri në muajin tetor 2023 është realizuar rehabilitimi i 13 km gyp me dimensione DN32 deri DN250. Ndërsa, në vitin 2024 do të realizohet pjesa tjetër e projektit. Kontribut në këtë drejtim është edhe investimi me gypa dhe valvula me fondet e Termokosit (95,000 euro) sipas buxhetit 2024.

Rehabilitimi/modernizimi nënstacioneve ekzistuese

Pjesë e projektit të KfW është edhe rehabilitimi – modernizimi i 270 nënstacioneve ekzistuese, në lagjet ekzistuese në të cilat është i shpërndarë rrjeti i ngrohjes, (Ulpiana, Dardania, Bregu i diellit dhe Qendër), nga të cilat deri më tani janë instaluar 228 nënstacione të reja dhe sipas projektit është duke vazhduar instalimi i 42 nënstacioneve të tjera.

Ndërsa, realizimi i riparimeve, remonteve dhe mirëmbajtja e rrjetit dhe termonënstacioneve nga ekipet e Termokosit, duhet të kryhet gjatë periudhës prill-tetor 2024.

Tabela 16. Planifikimi i riparimeve dhe remonteve -2024

PLANIFIKIMET E RIPARIMEVE, REMONTEVE DHE MIRËMBAJTJEVE NË VITIN 2024													
Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total muajt
Njësia e prodhimit të en. term.													
Gjeneratori U1						r		r	r				
Gjeneratori Un						r		r	r				
Njësia prodhuese në ngrohtore					r	r		r	r				
Rrjeti dhe nënstacionet				R	R,r	R,r	R	R,r	R,r	R,r			
Total R, r				R	R,2r	R,4r	R	R,4r	R,4r	R,r			

'R' I referohet Remonteve, Riparimeve Madhore; 'r' I referohet remonteve dhe riparimeve të zakonshme

Emetimi i ndotësve të ajrit nga impiantet e prodhimit të energjisë termike

Në rast të ndonjë pengese për furnizim me energji termike nga termocentrali "Kosova B", planifikohet që furnizimi me ngrohje të bëhet nga stabilimentet e prodhimit të energjisë termike në ngrohtore.

Mirëpo, meqenëse stacioni i mazutit (i vjetëri) është larguar për lirim të hapësirës për ndërtimin e objektit të ri administrativ, gjatë vitit 2024 në NQ nuk është planifikuar të shpenzohet mazut, (derisa të rivendoset në një vend tjetër). Bazuar në këtë fakt nuk është parashikuar emetimi i ndotësve të ajrit CO2 dhe SO2, nga prodhimi me mazut në kaldajat e ngrohtores "Termokos" për vitin 2024.

Përmbledhje e bilancit vjetor të energjisë termike

PËRMBLEDHJE E BILANCIT VJETOR TË ENERGJISË TERMIKE PËR VITIN 2024			
Nr.	Përshkrimi -viti 2024	Njësia	Vlera
1	Energjia nga lënda djegëse - mazuti	(MWh _{TH})	0
2	Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore	(%)	85
3	Prodhimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të Ngrohtores	(MWh _{TH})	0
4	Prodhimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh _{TH})	356,189
5	Total Bruto Prodhimi i energjisë termike	(MWh _{TH})	356,189
6	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh _{TH})	7,124
7	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	2
8	Konsumi vetanak	(MWh _{TH})	865
9	Neto Prodhimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	348,200
10	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	27,856
11	Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	(%)	8.0
12	Kërkesa/Furnizimi me energji termike	(MWh _{TH})	320,344
13	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	0
14	Sipërfaqja ngohëse	m ²	1,933,763
15	Numri i nënstacioneve termike (aktive / pasive)		880/20
16	Kapaciteti i instaluar prodhues	MW	274
17	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	113.60